NJOFTIM
Nr. 3515, datë 15.3.2017

MBI HYRJEN NË FUQI TË DISA MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

1. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Italisë për konvertimin e borxhit për zhvillim, nënshkruar më 17.6.2016, hyrë në fuqi më 6.2.2017.

2. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin në fushën e sigurisë, nënshkruar më 31.5.2013, hyrë në fuqi më 23.2.2017.

3. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mongolisë për përjashtimin nga kërkesa për vizë të mbajtësve të pasaportave biometrike diplomatike, shërbimit dhe zyrtare", nënshkruar në Gjenevë, më 28.2.2017, hyrë në fuqi më 29.3.2017.

4. Marrëveshje ndryshuese nr. 1 e Marrëveshjes për kontrollin e lëndëve narkotike dhe zbatimin e ligjit, i datës 1 korrik 2015, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nënshkruar më 21.9.2016, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.

5. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës për heqjen e ndërsjellë të kërkesave për vizë, nënshkruar në Tiranë, më 4.11.2016, hyrë në fuqi më 1.4.2017.

6. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbi Bashkëpunimin Financiar 2016 për projektin "Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri–Maqedoni", nënshkruar më 26.7.2016, hyrë në fuqi më 8.3.2017.

7. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbi Bashkëpunimin Financiar 2016 për projektin "Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri–Maqedoni (zgjerim)", nënshkruar më 28.10.2016, hyrë në fuqi më 8.3.2017.

8. Marrëveshje e Huas ndërmjet KfW Frankfurt am Main dhe Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave Huamarrësi, për Financimin e Programit të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, Rajoni Vlorë, nënshkruar më 15.12.2016, hyrë në fuqi më 13.3.2017.

9. Marrëveshje Financimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave si Marrës dhe KfW Frankfurt am Main, për Financimin e Shërbimeve të Ekspertit ndaj Marrësit në kuadër të një studimi për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta në Shqipëri nga një fond i veçantë (nr. 11469), dhënë nga qeveria gjermane, nënshkruar më 15.12.2016, hyrë në fuqi më 13.3.2017.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
Gazmend Barbullushi